

Fletë tematike e fakteve¹

Përditësimi i fundit:

Qershor 2018

MBROJTJA E BURIMEVE TË GAZETARËVE, GURTHEMEL I LIRISË SË SHTYPIT

Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e drejta e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre nuk është privilegj i thjeshtë për t'u dhënë ose marrë në varësi të ligjshmërisë ose paligjshmërisë së burimeve të tyre, por është pjesë kyçe e të drejtës për informim, për tu trajtuar me kujdes maksimal. Pa mbrojtje efektive, burimet mund të dekurajohen që të ndihmojnë shtypin për të informuar publikun për çështje me interes publik. Si pasojë mund të minohet roli jetik i "mbikëqyrësit publik" të shtypit.

Çdo ndërhyrje në të drejtën për mbrojtje të burimeve gazetareske (bastisjet në vendin e punës ose shtëpinë e gazetarëve, konfiskimi i materialit gazetaresk, urdhra për zbulim, etj.) që mund të çojë në identifikimin e tyre duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse efektive procedurale ligjore që janë proporcionale me rëndësinë e parimit të rrezikuar. E para dhe më e rëndësishmja nga këto masa mbrojtëse është garancia e shqyrtimit nga një organ i pavarur dhe i paanshëm për të parandaluar qasjen e panevojshme në informata të cilat mund të zbulojnë identitetin e burimeve. Një shqyrtim i tillë është parandalues për nga natyra. Organi i rishikimit duhet të jetë në gjendje të peshojë rreziqet e mundshme me interesat përkatëse para se të bëhet ndonjë zbulim. Vendimi i tij duhet të drejtohet nga kritere të qarta, përfshirë nëse masat më pak ndërhyrëse do të mjaftonin.

Urdhrat e zbulimit ndaj gazetarëve kanë ndikim të dëmshëm jo vetëm për burimet e tyre, identiteti i të cilave mund të zbulohet, por edhe për gazetën kundër së cilës drejtohet urdhri, reputacioni i së cilës mund të dëmtohet në sytë e burimeve të ardhshme të mundshme, madje edhe për publikun që kanë interes të marrin informacione të siguruara përmes burimeve anonime dhe të cilët mund të jenë vetë burim i informatave. Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së burimeve gazetareske për lirinë e shtypit në një shoqëri demokratike dhe efektin potencialisht frikësues që një urdhër për zbulimin e burimit të tyre e ka në ushtrimin e asaj lirie, një masë e tillë nuk mund të jetë në përputhje me Nenin 10 përpos nëse ajo justifikohet nga një kërkesë më e rëndësishme për interesin publik".

Përkthimi është
bashkë financuar nga
Bashkimi Evropian



¹ Ky dokument paraqet një përzgjedhje jo të plotë të instrumenteve të KiE-së dhe praktikës gjyqësore përkatëse të GjEDNj-së. Qëllimi i tij është të përmirësojë vetëdijësimin për veprimet ose mosveprimet e autoriteteve kombëtare që mund të përbëjnë pengesë sipas nenit 10 të Konventës. Ky informacion nuk është vlerësim ligjor i alarmimeve dhe nuk duhet të trajtohet ose të përdoret si i tillë.

Ky dokument është përkthyer në gjuhën shqipe në kuadër të projektit "Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave në Kosovë* pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022". Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë rast nuk mund të merren bazë për të reflektuar opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian

@ 2021 Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme ose përmes çfarëdo mjeti, qoftë elektronik (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çfarëdo sistemi depozitimi ose marrjeje informacioni, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

* Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Gazetarët e obliguar me urdhër gjyqësor të zbulojnë burimet e tyre gazetareske

Paraburgimi i një gazetari për ta detyruar të zbulojë burimin e tij të informacionit Voskuil k.

Holandës - [64752/01](#)

Aktgjykimi 22.02.2008

Parashtruesit, një gazetari, iu mohua e drejta për të mos zbuluar burimin e tij për dy artikuj që kishte shkruar për një gazetë në lidhje me një hetim penal të trafikut të armëve dhe u mbajt në paraburgim për më shumë se dy javë në përpjekje për ta detyruar ta tregojë burimin. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke gjetur në veçanti se interesi i Qeverisë Holandeze për të ditur identitetin e burimit të parashtruesit nuk ishte i mjaftueshëm për të anashkaluar interesin e parashtruesit për ta fshehur atë, vendosi se kishte pasur **shkelje të nenit 10** të Konventës. Gjykata më tej konstatoi se kishte pasur edhe **shkelje të nenit 5 § 1** (e drejta për liri dhe siguri) të Konventës në rastin e parashtruesit.

Kontrollimi i gazetarëve dhe urdhri që ata të dorëzojnë dokumente që mund të çojnë në identifikimin e burimeve të tyre

Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.V. dhe të tjerët k. Holandës - [39315/06](#)

Aktgjykimi 22.11.2012

Parashtruesit - një kompani me përgjegjësi të kufizuar, korporatë sipas ligjit holandez, botuese e gazetës ditore me qarkullim masiv *De Telegraaf*, dhe dy gazetarë - u ankuan kundër urdhrit për dorëzim të dokumenteve që mund të identifikonin burimet e tyre dhe kundër përdorimit të kompetencave speciale nga shteti.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerësoi se kishte pasur **shkelje të neneve 8** (e drejta për respektimin e jetës private) **dhe 10** të Konventës në lidhje me dy gazetarët, duke zbuluar në veçanti se ligji përkatës në Holandë nuk kishte siguruar masa mbrojtëse të përshtatshme në lidhje me kompetencat e mbikëqyrjes të përdorura kundër tyre, me qëllim zbulimin e burimeve të tyre gazetareske. Gjykata më tej vendosi se kishte pasur **shkelje të nenit 10** në lidhje me urdhrin për dorëzimin e dokumenteve drejtuar kompanisë botuese. Ajo ritheksoi në veçanti rëndësinë e mbrojtjes së burimeve gazetareske për lirinë e shtypit në një shoqëri demokratike dhe efektin potencialisht frikësues që një urdhër i zbulimit të burimeve mund të kishte në ushtrimin e kësaj lirie dhe zbuloi se nevoja për të identifikuar zyrtarin/zyrtarët e shërbimeve sekrete të cilët kishin furnizuar parashtruesit me dokumente sekrete nuk e kishte justifikuar urdhrin për dorëzimin e dokumenteve.

Kompania televizive urdhërohet t'i dorëzojë policisë pamjet e paredaktuara që përfshijnë një pedofil të dyshuar

Nordisk Film & TV A/S k. Danimarkës (dec.) - [40485/02](#),

Vendimi 8.12.2005

Ky rast kishte të bënte me një urdhër për të zbuluar materialin kërkimor të siguruar nga një gazetar i cili, duke bërë një dokumentar mbi pedofilinë në Danimarkë, vepronte në mënyrë të fshehtë dhe u përfshi në shoqëri pedofilësh. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e shpalli kërkesën të **papranueshme** pasi ishte qartazi e pabazuar. Në veçanti gjeti se urdhri i gjykatës vendore kishte qenë ndërhyrje proporcionale në lirinë e shprehjes së gazetarit që ishte e justifikueshme për parandalimin e krimit, veçanërisht në lidhje me një rast të rëndë të abuzimit të fëmijëve.

Urdhri gjyqësor që u kërkon mediave të zbulojnë një dokument të siguruar në mënyrë të fshehtë e që mund të çojë në identifikimin e burimit të tyre

Financial Times Ltd dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar - [821/03](#)

Aktgjykimi 15.12.2009

Ky rast kishte të bënte me ankesën nga katër gazeta të Mbretërisë së Bashkuar dhe një agjenci lajmesh se ata ishin urdhëruar të zbulonin dokumente për *Interbrew*, një kompani belge e birrës, gjë që mund të çonte në identifikimin e burimeve gazetareske në zanafillën e një informate dorëzuar shtypit në mënyrë të fshehtë rreth një oferte për ta blerë kompaninë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 10**të Konventës. Duke theksuar në veçanti efektin ftohës që shfaqet sa herë që gazetarët shiheshin duke ndihmuar në identifikimin e burimeve anonime, ajo gjeti se interesat në eliminimin e dëmit përmes shpërndarjes së ardhshme të informacionit konfidencial dhe në sigurimin e dëmshpërblimit për shkeljet e besimit në të kaluarën, ishin, edhe nëse konsideroheshin në përgjithësi, të pamjaftueshme për të tejkaluar interesin publik për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve.

Sekuestrimi nga policia i materialit që mund të kishte çuar në identifikimin e

burimeve gazetareske Sanoma Uitgevers BV k. Holandës [GC] - [38224/03](#)

Aktgjykimi 14.9.2010

Ky rast kishte të bënte me fotografi që do të përdoreshin për një artikull mbi garat e paligjshme të makinave, të cilat një kompani holandeze e botimit të revistave ishte e detyruar t'ua dorëzonte policisë që ishte duke hetuar një krim tjetër, pavarësisht kundërshtimeve të forta të gazetarëve për t'u detyruar të zbulojnë materiale që mund të çonin në identifikimin e burimeve konfidenciale . Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjeti në veçanti se ndërhyrja në lirinë e shprehjes së kompanisë parashtruese nuk ishte "parashikuar me ligj", pasi nuk kishte pasur asnjë procedurë me masa mbrojtëse ligjore të përshtatshme për kompaninë parashtruese për të mundësuar një vlerësim të pavarur nëse interesi i hetimit penal mbizotëronte interesin publik për mbrojtjen e burimeve gazetareske. Kështu që ka pasur **shkelje të Nenit 10** të Konventës.

Urdhri për zbulim që i pranohet një kompanie private i justifikuar nga një kërcënim i dëmit të rëndë për biznesin e saj dhe jetesën e punonjësve të saj

Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar - [17488/90](#)

Aktgjykimi 27.3.1996

Rasti kishte të bënte me një urdhër zbulimi të shqiptuar ndaj një gazetari (që punonte për revistën) *The Engineer*) duke i kërkuar atij të tregonte identitetin e burimit të tij të informacionit rreth planit konfidencial të punës së një kompanie. Sipas mendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk kishte një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis qëllimit legjitim të ndjekur nga urdhri i zbulimit dhe mjeteve të përdorura për të arritur atë qëllim. Si urdhri që i kërkonte parashtruesit të zbulonte burimin e tij, ashtu edhe gjoha e shqiptuar ndaj tij pasi kishte refuzuar ta pranonte, përbënin **shkeljetë të drejtës së tij për liri të shprehjes sipas Nenit 10** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Urdhërimi i një gazetari për të dhënë dëshmi për një burim nuk ishte i justifikuar, edhe pse vetë burimi kishte shkuar në polici

**Becker k. Norvegjisë -
[21272/12](#) Aktgjykimi
5.10.2017**

Para Gjykatës Evropiane, parashtruesja pretendonte se ishte detyruar që të jepte një dëshmi e cila do të mundësonte identifikimin e një apo më shumë burimeve gazetareske, që do të shkelnin të drejtën e saj sipas Nenit 10 për të pranuar dhe për të dhënë informacion.

Në gusht 2007, parashtruesja, një gazetare, shkroi një artikull në lidhje me një kompani të cituar në bursë këmbimi, bazuar në një bisedë telefonike me një z. X dhe një letër të hartuar nga një avokat. Në qershor 2010 z. X u akuzua për manipulim të tregut dhe tregti të brendshme. Ai ishte akuzuar se i kishte kërkuar avokatit të hartonte letrën e cila krijonte përshtypjen se ishte shkruar në emër të një numri të mbajtësve të obligacioneve të shqetësuar për likuiditetin e kompanisë, financat dhe të ardhmen, kur në fakt, ishte shkruar vetëm në emër të i z. X, i cili zotëronte një obligacion të vetëm, të cilin e kishte siguruar kohëve të fundit. Pas publikimit të artikullit të parashtrueses, çmimi i aksioneve të kompanisë ra.

Parashtruesja më pas u mor në pyetje nga policia, e cila e informoi atë se z. X e kishte pranuar se ia kishte dhënë asaj letrën. Parashtruesja tha se ishte e gatshme të deklaronte se e kishte marrë letrën, por nuk pranonte të jepte informacion shtesë me arsyetimin se burimet gazetareske ishin të mbrojtura. Gjatë procedurave penale kundër z. X, parashtruesja u thirr si dëshmitare. Duke u thirrur në ligjin vendor dhe nenin 10 të Konventës, ajo refuzoi të dëshmonte.

Gjykata e shkallës së parë vendosi që parashtruesja kishte për detyrë të jepte dëshmi në lidhje me kontaktet e saj me z. X në lidhje me letrën e avokatit. Në vitin 2011, Gjykata Supreme e rrëzoi ankesën e parashtrueses, duke vlerësuar se nuk do të ndodhte asnjë shkelje e Konventës pasi që burimi veçse e kishte zbuluar veten, andaj nuk kishte asnjë burim për të mbrojtur. Arsyetimi kryesor për mbrojtjen e burimit bazohej në pasojat që zbulimi i identitetit të një burimi mund të ketë për rrjedhën e lirë të informacionit. Parashtruesja u gjobit me 3,700 euro për një vepër që kishte kundërshtuar një urdhër gjyqësor.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk ishte e bindur që ndonjëra nga rrethanat në rastin në fjalë ose arsyet e paraqitura e kishin justifikuar detyrimin e znj. Becker që të dëshmonte. Ajo theksoi që refuzimi i saj për të zbuluar burimin (ose burimet) e saj nuk kishte penguar në asnjë moment as hetimin ose procedurën kundër z. X. Në të vërtetë, gjykata e shkallës së parë që dënoi z. X ishte informuar nga prokurori se nuk ishte bërë asnjë kërkesë për zgjatje (në pritje të një vendimi përfundimtar për detyrën për të dhënë prova), pasi që rasti ishte zbuluar mjaftueshëm edhe pa deklaratën e znj. Becker. Gjykata po ashtu kishte parasysh se metodat gazetareske të zonjës Becker nuk ishin vënë kurrë në dyshim dhe ajo nuk ishte akuzuar për ndonjë veprimtari të paligjshme. Për më tepër, e drejta e saj si gazetare për të mbajtur burimet e saj konfidenciale nuk mund të hiqej automatikisht për shkak të sjelljes së një burimi ose për shkak se identiteti i burimit ishte bërë i njohur.

Përfundimi: shkelje e nenit 10 të Konventës

Bastisjet e shtëpisë së gazetarëve ose vendit të punës dhe/ose sekuestrimi i materialit gazetaresk

Kompetenca të gjera të dhëna oficerëve të hetimit të cilët kryen bastisje në shtëpitë dhe vendin e punës së gazetarëve

Roemen dhe Schmitt k. Luksemburgut [51772/99](#)

Aktgjykimi 25 shkurt 2003

Parashtruesit në këtë rast ishin një gazetar dhe avokati i tij në procedurat vendore. Rasti kishte të bënte me një bastisje dhe kontroll të paparalajmëruar nga policia në shtëpinë e parashtruesit të parë pas publikimit të një artikulli në lidhje me mashtrim tatimor nga një ministër qeveritar. Hetuesit e armatosur me urdhër kërkimi kryen hetime të gjera. Gjyqtari hetues po ashtu kishte urdhëruar një kontroll në avokatinë e parashtruesit të parë.

Duke marrë parasysh që Qeveria nuk kishte treguar se ishte ruajtur baraspesha midis interesave në fjalë, përkatësisht mbrojtjes së burimeve nga njëra anë dhe parandalimit dhe ndëshkimit të krimit nga ana tjetër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi që masat në fjalë kishin qenë joproporcionale dhe kishin cenuar të drejtën e parashtruesit të parë për liri të shprehjes. Kështu që ka pasur **shkelje të Nenit 10** të Konventës në lidhje me parashtruesin e parë. Gjykata më tej konstatoi se kontrolli i kryer në zyrën e avokatit të parashtruesit të parë kishte pasoja për të drejtat e parashtruesit të parë sipas nenit 10 të Konventës. Duke gjykuar se kontrolli në zyrën e parashtruesit të dytë kishte qenë joproporcional me qëllimin e ndjekur, veçanërisht përkitazi me shpejtësinë me të cilën ishte kryer, Gjykata erdhi në përfundim se në këto rrethana kishte pasur **shkelje të nenit 8** (e drejta për respektimin e shtëpisë) të Konventës në lidhje me parashtruesin e dytë.

Bastisjet masive të vendeve të punës, shtëpive dhe, në disa raste, veturave të gazetarëve për të identifikuar gjyqtarët që kanë zbuluar informacione në lidhje me rastet e hapura penale

Ernst dhe të tjerët k. Belgjikës [33400/96](#)

Aktgjykimi 15.7.2003

Parashtrues në këtë rast ishin katër gazetarë. Rasti kishte të bënte me bastisjet në zyrat e gazetave belge dhe katër shtëpitë e gazetarëve nga Departamenti e Krimeve të Rënda në lidhje me ndjekjen penale të anëtarëve të shërbimit juridik shtetëror në Gjykatën e Apelit të Liège për shkelje të besimit pas rrjedhjes së informatave në raste shumë të ndjeshme penale.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 10** të Konventës. Ajo gjeti në veçanti se arsyet e dhëna nga gjykatat vendore nuk ishin të mjaftueshme për të justifikuar bastisjet dhe konfiskimet në një shkallë kaq të gjerë. Në këtë rast Gjykata më tej konstatoi se kishte pasur shkelje të Nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private), nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1 (e drejta për gjykim të drejtë), as shkelje të Nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 6 § 1 dhe se nuk kishte pasur shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) të Konventës.

Arsye të pamjaftueshme të dhëna nga gjykatat belge për të justifikuar bastisjet

Tillack kundër Belgjikës [20477/05](#)

Aktgjykimi 27.11.2007

Parashtruesi, gazetar i revistës javore gjermane *Stern*, u ankua për bastisjet dhe konfiskimet në shtëpinë e tij dhe vendin e tij të punës pas botimit të artikujve në lidhje me parregullsitë në institucionet evropiane të mbështetura në informacione nga dokumentet konfidenciale nga Zyra Evropiane e Kundër Mashtrimit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 10** të Konventës. Ajo në veçanti theksonte se e drejta e një gazetari për të mos zbuluar burimet nuk mund të konsiderohej si

privilegj i thjeshtë për t'u dhënë ose marrë në varësi të ligjshmërisë ose paligjshmërisë së burimeve të tyre, por ishte pjesë e të drejtës për informim. Ajo gjeti arsyet e dhëna nga gjykatat belge për të justifikuar bastisjet si të pamjaftueshme.

Bastisja joproporcionale e ambienteve të një gazete ditore për të përcaktuar në çfarë rrethanash dhe kushtesh gazetarët kishin siguruar një kopje të një raporti konfidencial

Martin dhe të tjerët k. Francës [30002/08](#)

Aktgjykimi 12.04.2012

Ky rast kishte të bënte me një bastisje të lokaleve të gazetës ditore *Midi Libre* urdhëruar nga një gjyqtar hetues për të përcaktuar në çfarë rrethanash dhe kushtesh gazetarët kishin siguruar një kopje të një raporti konfidencial të Zyrës Rajonale të Auditimit në lidhje me menaxhimin e rajonit Languedoc-Roussillon.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 10**të Konventës. Në veçanti, Qeveria Franceze nuk kishte demonstruar se interesat që kanë rënë ndesh - domethënë mbrojtja e burimeve të gazetarëve dhe parandalimi dhe shtypja e krimit - ishin ekuilibruar siç duhet. Arsyet e dhëna nga autoritetet për të justifikuar bastisjen mund të konsiderohen të rëndësishme, por jo të mjaftueshme. Rrjedhimisht, bastisja kishte qenë joproporcionale.

Bastisjet e kryera në ambientet e gazetave dhe në shtëpitë e gazetarëve të akuzuar për shkelje të konfidencialitetit të një hetimi gjyqësor duke riprodhuar pjesë nga të dhënat e transkriptimeve të bisedës së përgjuar telefonike

Ressiot dhe të tjerët k. Francës nr. 15054/07

Aktgjykimi 28.06.2012

Ky rast kishte të bënte me hetimet e kryera në ambientet e gazetave *L'Equipe* dhe *Le Point* dhe në shtëpitë e gazetarëve të akuzuar për shkelje të konfidencialitetit të një hetimi gjyqësor. Autoritetet donin të identifikonin burimin e rrjedhjeve në një hetim të dopingut të mundshëm në garat me biçikleta.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 10**të Konventës. Ajo gjeti në veçanti se Qeveria Franceze nuk kishte treguar se ishte vendosur një baraspeshë e drejtë midis interesave të ndryshme të përfshira. Masat e ndërmarra nuk kishin qenë proporcionale në mënyrë të arsyeshme me ndjekjen e qëllimit legjitim në fjalë, duke pasur parasysh interesin e një shoqërie demokratike në sigurimin dhe ruajtjen e lirisë së shtypit.

Urdhri për bastisje dhe konfiskim i përpiluar me gjuhë të përgjithësuar që nuk përjashton zbulimin e burimeve të gazetarit

Saint-Paul Luxembourg S.A. k. Luksemburgut - [26419/10](#)

Aktgjykimi 18.04.2013

Ky rast kishte të bënte me një urdhër bastisjeje dhe sekuestrimi të lëshuar nga një gjyqtar hetues kundër një gazete pasi kjo e fundit kishte botuar një artikull i cili ishte objekt i ankesës tek autoritetet gjyqësore nga një individ i përmendur në artikull dhe punëdhënësi i tij.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjeti **shkelje të nenit 8** (e drejta për respektimin e jetës private) dhe **shkelje të nenit 10** të Konventës. Ajo në veçanti gjeti se urdhri për bastisje dhe sekuestrim nuk ishte proporcional me qëllimin e ndjekur, përkatësisht për të verifikuar identitetin e gazetarit që kishte shkruar artikullin dhe se ai kishte qenë i kufizuar në mënyrë të pamjaftueshme për të parandaluar abuzimin e mundshëm nga hetuesit, për shembull në formën e përpjekjeve për të identifikuar burimet e gazetarit.

Bastisje urgjente në shtëpinë e gazetares që përfshin sekuestrimin e pajisjeve për ruajtjen e të

dhënave që përmbajnë burimet e saj të informacionit

Nagla k. Letonisë 73469/10

Aktgjykimi 16.07.2013

Ky rast kishte të bënte me bastisjen nga policia të shtëpisë së një gazetareje të njohur të televizionit dhe sekuestrimin e pajisjeve për ruajtjen e të dhënave. Shtëpia e saj u bastis pas një transmetimi që kishte bërë në shkurt 2010 duke informuar publikun për një rrjedhje informacioni nga baza e të dhënave të Shërbimit Shtetëror të të Ardhurave.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 10**të Konventës. Ajo theksoi në veçanti se e drejta e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre nuk mund të konsiderohej privilegj që varet nga ligjshmëria ose paligjshmëria e burimeve të tyre, por më tepër si pjesë përbërëse e së drejtës për informacion që duhet të trajtohet me kujdesin më të madh. Në këtë rast, autoritetet hetimore nuk kishin arritur të baraspeshonin siç duhet interesin e hetimit për sigurimin e provave në raport me interesin publik për mbrojtjen e lirisë së shprehjes së gazetarit.

Një informator i një gazete për një varg sulmesh me bomba nuk

është "burim" Stichting Ostade Blade k. Holandës 8406/06

27.05. 2014 (vendim për pranueshmërinë)

Ky rast kishte të bënte me bastisjen e lokaleve të një reviste pas një njoftimi për shtyp që lëshoi duke njoftuar se kishte marrë një letër nga një organizatë që merrte përsipër përgjegjësinë për një varg sulmesh me bomba në Arnhem. Botuesi i revistës u ankua në veçanti se bastisja përbënte shkelje të së drejtës së tyre për të mbrojtur burimet e gazetarëve.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e shpalli kërkesën të **papranueshme** pasi ishte qartazi e pabazuar. Ajo arriti në përfundimin se "mbrojtja e burimit" nuk ishte në pyetje në këtë rast pasi informatori i revistës, i cili po kërkonte publicitet për sulmet përmes mbulimit nga shtypi, nuk gëzonte të drejtën për të njëjtën mbrojtje siç u jepej zakonisht "burimeve". Bastisja, e cila ishte kryer për të hetuar një krim të rëndë dhe për të parandaluar sulme të mëtejshme, kishte qenë në përputhje me kërkesat e nenit 10 të Konventës, veçanërisht për të qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike për parandalimin e krimit.

Bastisja e lokaleve profesionale dhe sekuestrimi i dokumenteve që synojnë të identifikojnë burimet gazetareske Görmüş dhe të tjerët k. Turqisë

Aktgjykimi 19.01.2016 [49085/07](#)

Në prill 2007 revista javore *Nokta* botoi një artikull bazuar në dokumente të klasifikuara "konfidenciale" nga Shefi i Shtabit të forcave të armatosura. Parashtruesit - respektivisht drejtori i botimit dhe kryeredaktorët e revistës javore në atë kohë, si dhe gazetarët hulumtues që punuan për botimin - u ankuan se masat e marra nga autoritetet përkatëse, veçanërisht bastisja e objekteve të tyre të punës dhe sekuestrimi i dokumenteve të tyre kishin për qëllim identifikimin e burimeve të tyre të informacionit dhe shkeljen e të drejtës së tyre për lirinë e shprehjes, veçanërisht të drejtën e tyre për të marrë ose dhënë informacion si gazetarë.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 10**të Konventës. Ajo gjeti në veçanti se artikulli i botuar nga revista javore *Nokta*, në bazë të dokumenteve ushtarake "konfidenciale" në lidhje me një sistem për klasifikimin e mediave në bazë të asaj se a ishin "të favorshme" ose "të pafavorshme" për forcat e armatosura mund t'i kontribuonte debatit publik. Duke theksuar rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështjet me interes publik dhe nevojën për të mbrojtur burimet gazetareske, përfshirë edhe kur ato burime ishin zyrtarë shtetërorë duke theksuar praktikën e pakënaqshme në vendin e tyre të punës, Gjykata vendosi që ndërhyrja në të drejtën e gazetarëve për liri

të shprehjes, veçanërisht në të drejtën e tyre për të informuar, nuk kishte qenë proporcionale me qëllimin legjitim të kërkuar, nuk kishte përmbushur një nevojë të ngutshme shoqërore dhe për këtë arsye nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike; ndërhyrja konsistonte në sekuestrimin, nxjerrjen dhe ruajtjen nga autoritetet e të gjitha të dhënave kompjuterike të revistës, madje edhe të dhëna që nuk kishin lidhje me artikullin, me qëllim identifikimin e sinjalizuesve të sektorit publik. Së fundmi, Gjykata konsideronte se një masë e tillë do të pengonte burimet e mundshme të ndihmonin shtypin në informimin e publikut për çështje me interes të përgjithshëm, përfshirë rastet që kishin të bënin me forcat e armatosura.

Autoritetet doganore lejuan të ekzaminojnë të dhënat në një laptop të gazetarit dhe t'i kopjojnë ato - legjislacioni i pretenduar i mangët

Ivaschenko k. Ruisë nr. [61064/10](#)

Aktgjykimi 13.2.2018

Parashtruesi është fotoreporter. Përderisa kthehej në Rusi pas një udhëtimi në Abkhazia, ku kishte bërë disa fotografi në lidhje me, siç e përshkroi ai, "jetën e kësaj Republike të panjohur", sendet e tij, duke përfshirë një laptop dhe disa pajisje elektronike të ruajtjes së informatave, iu nënshtruan një kontrolli. Parashtruesi ankohet në veçanti se autoritetet doganore në mënyrë të paligjshme dhe pa arsye të vlefshme ekzaminuan të dhënat në laptopin e tij dhe pajisjet e ruajtjes. Ai më tej argumenton se veprimet e autoriteteve doganore kanë shkelur të drejtën e tij për liri të shprehjes dhe, në veçanti, se nuk kishte masa të mjaftueshme mbrojtëse procedurale për ta mbrojtur atë nga ndërhyrjet e pajustificuara ose për të mbrojtur burimet gazetareske.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut Gjykata theksoi se kontrolli i laptopit të parashtruesit (siç pretendohet pa ndonjë dyshim të arsyeshëm për ndonjë vepër penale ose sjellje të paligjshme), kopjimi i të dhënave personale dhe profesionale pasuar nga komunikimi i tyre për një vlerësim të specializuar dhe mbajtja e të dhënave të tij për rreth dy vjet kishin shkuar përtej asaj që mund të perceptohet si procedura që ishin "rutinë", relativisht joinvazive dhe për të cilat zakonisht jepej pëlqimi. Parashtruesi nuk ishte në gjendje të zgjidhte nëse pajtohej të paraqitej dhe t'i paraqiste sendet e tij në doganë dhe për një inspektim të mundshëm doganor. Sipas gjykatës, duke paraqitur sendet e tij në kontrollet doganore, një person nuk heq dorë automatikisht dhe në të gjitha rastet nga e drejta për respektimin e "jetës private", ose siç mund të ishte në këtë rast, "korrespondencës" së tij.

Kështu që parashtruesi e kishte të hapur mundësinë të mbështetej në të drejtën e tij për respektim të jetës private dhe kishte pasur ndërhyrje sipas nenit 8 të Konventës.

Gjykata vazhdoi të shqyrtojë nëse ndërhyrja ishte e justifikuar. Duke pasur parasysh arsyetimin e vendimeve të gjykatave vendore, Gjykata nuk ishte e kënaqur që leximi i kombinuar i dispozitave përkatëse të Kodit Doganor dhe rregullave të tjera ligjore përbënte një interpretim të parashikueshëm të ligjit kombëtar dhe siguronte një bazë ligjore për kopjimin e të dhënave elektronike nga dokumente elektronike të ruajtura njësi softuerike "kontejner" siç ishte laptopi.

Veç kësaj, masat mbrojtëse të parashikuara me ligjin rus nuk përbënin ndonjë kornizë adekuate për kompetencat e gjera që i ishin dhënë ekzekutivit, të cilat mund t'u ofronin individëve mbrojtje adekuate ndaj ndërhyrjeve arbitrare.

Së pari, Gjykata nuk ishte e kënaqur që ekzistonte një kërkesë e qartë në fazën e autorizimit që inspektimi dhe, para së gjithash, kopjimi të varej nga ndonjë kriter i vlerësimit të proporcionalitetit të masës. Ishte e qartë se qasja e zakonshme për marrjen e mostrave të "mallrave" nga doganat nuk ishte adekuate në lidhje me të dhënat elektronike.

Së dyti, nuk dukej që masa gjithëpërfshirëse e përdorur në rastin e parashtruesit të ishte e bazuar në

ndonjë nocion të një dyshimi të arsyeshëm se dikush që bën një deklaratë doganore kishte kryer një shkelje. Kjo mungesë e dukshme e nevojës për të pasur dyshim të arsyeshëm në lidhje me një vepër u përkeqësua nga fakti që autoritetet vendore, në fund të fundit gjykatat për rishikimin gjyqësor, nuk u përpoqën të përcaktonin dhe të zbatonin nocione nga legjislacioni përkatës vendor siç janë "propaganda për fashizmin" ose "armiqësi shoqërore, racore, etnike ose fetare" në ndonjërin prej fakteve të konstatuara.

Së treti, Gjykata nuk ishte e bindur që fakti që parashtruesi po kthehej nga një zonë konfliktuozë (Abkhazia) përbënte në vetvete një bazë të mjaftueshme për të vazhduar me ekzaminimin e gjerë dhe kopjimin e të dhënave të tij elektronike për shkak të përmbajtjes së mundshme "ekstremiste".

Së fundmi, ndonëse ushtrimi i kompetencave për të inspektuar dhe marrë mostra i nënshtrohej rishikimit gjyqësor, shkalla e gjerë e atyre kompetencave ishte e tillë që parashtruesi përballej me pengesa të mëdha për të treguar se veprimet e zyrtarëve doganorë ishin të paligjshme, të pajustificueshme ose në kundërshtim me ligjin rus.

Kështu, kishte mangësi në kornizën rregullatore vendore pasi autoriteteve vendore, përfshirë gjykatat, nuk u kërkohet të jepnin arsye përkatëse dhe të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen në çështjen në fjalë dhe nuk e konsideruan të rëndësishme, në asnjë fazë ose në asnjë mënyrë, që parashtruesi bartte material gazetaresk.

Si përmbledhje, Qeveria e paditur nuk kishte demonstruar bindshëm se legjislacioni dhe praktika përkatëse ofronte masa mbrojtëse adekuate dhe efektive kundër abuzimit në një situatë ku procedura e marrjes së mostrave ishte përdorur edhe në lidhje me të dhënat elektronike të ruajtura në një pajisje elektronike. Andaj ndërhyrja nuk ishte "në përputhje me ligjin".

Përfundimi – shkelje e nenit 8 të Konventës

Instrumente të tjera të rëndësishme të Këshillit të Evropës

Rekomandimi Nr. R (2000) 7 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare për të drejtën e gazetarëve që të mos zbulojnë burimet e tyre të informacionit (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 8 mars 2000 në takimin e 701 të zëvendësministrave)

“Komiteti i Ministrave (...)

Të bindur se mbrojtja e burimeve të informacionit të gazetarëve përbën kusht themelor për punën dhe lirinë gazetare si dhe për lirinë e medias;

Duke kujtuar që shumë gazetarë kanë shprehur në kodet profesionale të sjelljes detyrimin e tyre për të mos zbuluar burimet e tyre të informacionit në rast se ata i kanë marrë informacionet në mënyrë konfidenciale;

Duke kujtuar që mbrojtja e gazetarëve dhe burimeve të tyre është vendosur në sistemet juridike të disa shteteve anëtare;

Duke kujtuar gjithashtu se ushtrimi nga gazetarët i të drejtës së tyre për të mos zbuluar burimet e tyre të informacionit mbart detyra dhe përgjegjësi siç përshkruhen në nenin 10 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

Të vetëdijshëm për Rezolutën e Parlamentit Evropian të vitit 1994 mbi konfidencialitetin për burimet e gazetarëve dhe të drejtën e nëpunësve civilë për të dhënë informacion; (...)

U rekomandon qeverive të shteteve anëtare:

1. të zbatojnë në ligjin dhe praktikën e tyre të brendshme parimet e bashkangjitura në këtë rekomandim,
2. të shpërndajnë gjerë e gjatë këtë rekomandim dhe parimet e tij të bashkangjitura, kur është e përshtatshme shoqëruar me përkthim, dhe
3. t'i sjellin ato në veçanti në vëmendjen e autoriteteve publike, autoriteteve policore dhe gjyqësorit si dhe t'i vënë ato në dispozicion të gazetarëve, mediave dhe organizatave të tyre profesionale. (...)

Rekomandimi 1950 (2011) i Asamblesë Parlamentare “Mbrojtja e burimeve të gazetarëve”

“Asambleja vëren me shqetësim numrin e madh të rasteve në të cilat autoritetet publike në Evropë kanë detyruar ose janë përpjekur të detyrojnë gazetarët të zbulojnë burimet e tyre, pavarësisht standardeve të qarta të vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komiteti i Ministrave. Këto shkelje janë më të shpeshta në vendet anëtare pa legjislacion të qartë. Në rastet e gazetarisë hulumtuese, mbrojtja e burimeve ka rëndësi edhe më të madhe ()

Autoritetet publike nuk duhet të kërkojnë zbulimin e informacionit që identifikon një burim përveç nëse plotësohen kërkesat e nenit 10, paragrafi 2, të Konventës dhe nëse nuk mund të vërtetohet bindshëm se masat alternative të arsyeshme për zbulimin nuk ekzistojnë ose janë shterur, interesi legjitim për zbulimin e tejkalon qartë interesin publik për mosdeklarim dhe një kërkesë mbizotëruese e nevojës për zbulim është provuar.

Zbulimi i informacionit që identifikon një burim duhet të jetë i kufizuar në rrethana të jashtëzakonshme kur interesat jetike publike ose individuale janë në rrezik dhe kur këto rrethana mund të vërtetohen bindshëm. Autoritetet kompetente, kur kërkojnë në mënyrë të veçantë zbulimin e një burimi, duhet të specifikojnë arsyet pse një interes i tillë jetik tejkalon interesin për mosdeklarim dhe nëse masat alternative janë shterur, siç janë provat e tjera. Nëse burimet mbrohen nga çdo zbulim sipas ligjit kombëtar, atëherë nuk duhet të kërkohe zbulimi i tyre. (...)

Ky dokument është përkthyer në gjuhën shqipe në kuadër të projektit "Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave në Kosovë" pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022". Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë rast nuk mund të merren bazë për të reflektuar opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian

Përkthimi është
bashkë financuar nga
Bashkimi Evropian

